



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

Nr. 938/2 Prot.

Tiranë, më 29.07.2026

Lënda: **Dërgim oponence teknike**

BASHKISË HAS

Sheshi “Dëshmorët e Hasit”, Qyteti Krumë

Në bazë të kërkesës suaj me Nr.2483 prot, datë. 06.07.2026, protokolluar me tonën me Nr.938 prot, datë.07.07.2026 **“Kërkesë për kryerjen e Oponencës teknike”**, po ju dërgojmë në 2 kopje, oponencën teknike të projektit të zbatimit të objektit: **“Rehabilitim i kanalit Ushqyes të Ujëmbledhësit Llakaj dhe Rehabilitimi i skemës ujitëse”, Has.**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Persida SHKREPA

OPONENCË TEKNIKE
MBI PROJEKTIN E ZBATIMIT TË OBJEKTIT:
“REHABILITIMI I KANALIT USHQYES TË
UJËMBLEDHËSIT LLAKAJ DHE REHABILITIMI I SKEMËS
UJITËSE”, BASHKIA HAS

POROSITËS : BASHKIA HAS

PROJEKTUES : SHOQËRIA “GL CONSTRUCTION” SHPK Nr.Lic.N.6780/18

GRUPI I PROJEKTIMIT:

- | | | |
|---|----------------------------------|-----------------|
| - | Ing. Ndërtimi. Gramos SKËNDA | Nr.Lic.K.1894/2 |
| - | Ing.Armand GJINI | |
| - | Ing.Gjeodet. Maksim SHEHU | Nr.Lic.T.0025/4 |
| - | Ekspert Mjedisi. Kreshnik AHMETI | Nr.Cert. A.2870 |

Bëhet kjo oponence teknike për projekt zbatimin e objektit: **“REHABILITIMI I KANALIT USHQYES TË UJËMBLEDHËSIT LLAKAJ DHE REHABILITIMI I SKEMËS UJITËSE”, BASHKIA HAS**, mbështetur në Ligjin Nr. 8402 dt. 10/09/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Neni 6”, ne VKM Nr.9, dt. 11.01.2024 “ Per Miratimin e Rregullave per Projektet qe duhet ti nenshtrohet Oponences Teknike sipas seiciles fushe projektimi si dhe procedurat qe ndiqen ne keto raste dhe në Urdherin e Ministrit Nr.197 dt. 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponences teknike për projektet e veprave të ndërtimit” dhe në Vendimin Nr.354, dt.11/05/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Grupit të Oponencës i janë vënë në dispozicion këto materiale:

- Kërkesa për kryerjen e Oponencës Teknike e Bashkisë Has me Nr.2483 Prot. Datë .06.07. 2026 dhe me Nr.938 Prot, Datë . 07.07. 2026 të Institutit të Ndërtimit.
- Marrëveshja midis Bashkisë Has dhe Institutit të Ndërtimit me Nr.1820 Prot, datë.20.05.2026 dhe me nr. 938/1 prot, datë.19.07.2026 te IN-se ku Tarifa e shërbimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

për kryerjen e oponencës teknike është **325,166** (treqind e njezet e pesemije e njeqind e gjashtedhjetë e gjashtë) lekë me TVSH.

- Detyra e Projektimit
- Relacion Teknik
- Relacion Topografik
- Relacioni Konstruktiv
- Relacioni Gjeologo - Inxhinierik
- Raporti i Llogaritjeve Hidraulike
- Vizatimet teknike
- Skema Ujitese e zones
- Specifikimet Teknike
- Preventivi i Punimeve dhe Analizat e cmimeve
- Grafiku i Punimeve
- Raporti VNM
- PSK
- Licenca e firmes Konsulente dhe eksperteve
- Deklaratat e pergjegjesise
- Materialet jane paraqitur ne menyre elektronike CD

Mangësi në paraqitjen e materialeve për kryerjen e oponencës teknike:

- Mungon nje Plan i detajuar organizimi duke perfshire vendndodhja e karrierave te materialeve
- Raporti i VNM , duhet te paraqitet i firmosur nga autori, shoqeruar dhe me licensen
- Licensat perkatese te specialisteve projektues
- Polica e sigurimit te projektueseve te projektit

Materiali i dorëzuar, do të konsiderohet i mirëqenë dhe i saktë nga ana ligjore, absolutisht në përgjegjësi të dorëzuesit dhe do të shërbejë si bazë për vlerësimin e projektit dhe hartimin e Oponencës Teknike.

1. TË PËRGJITHSHME

1.1 DETYRA PROJEKTIMIT

Detyra e projektimit eshte pjese e dokumentacionit teknik te dorezuar prane Oponences. Sipas Relacionit teknik, detyra e projektimit eshte hartuar nga Bashkia Has.

Sipas kesaj detyre ky projekt do te synoj rehabilitimin e kanalit te ushqimit te Ujembledhesit Llakaj me qellim furnizimin me uje te tokave bujqesore te kesaj zone dhe per pasoje rritjen e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

afetise ujtese dhe permiresimin e skemes se ujitjes nga ky ujembledhes. Bazuar ne kete qellim parashikohet

- Te rehabilitohet vepra e marrjes se ujit ne digen e ujembledhesit te Llakaj,
- Te pastrohet dhe te rehabilitohet kanali ushqyes me gjatesi $L=2075$ ml
- Te pastrohet dhe te rehabilitohet kanali ushqyes me gjatesi $L=945$ ml qe pershkron tokat deri ne rezervuarin perkates I cili duhet te vishet edhe me beton:

Ne kete detyre projektimi rezulton se gjendja teknike e objekteve eshte e amortizuar dhe me mjaft probleme teknike si pasoje e mungeses se mirembajtjes se kanaleve gjate viteve te fundit. Ne detyren e projektimit, jepen kerkesat e projektit si dhe standartet qe duhet te perdoren gjate hartimit te projektit si dhe paraqitjes se dokumentacionit teknik. Duke perfshire dhe raportet perkatese gjeologjike, topografike, hidraulike dhe te vleresimit te ndikimit ne mjedis.

Edhe ne relacionin teknik te pregatitur nga Konsulenti eshte dhene nje pershkrim i gjendjes aktuale te kanaleve si dhe detyrat kryesore te kerkuara ne detyren e projektimit ku pasi jepet nje pershkrim i gjendjes ekzistuese dhe i problematikave qe rezultojne ne zone jepen edhe konkluzionet ne lidhje me punimet qe duhet te kryhen per pastrimin dhe rehabilitimin e ketyre kanaleve ushqyes si dhe kerkesat qe duhet te zgjidhe projekti. Ne dokumentacionin teknik te dorezuar eshte dhene vetem dokumentat ne lidhje me fazen e projekt zbatimit dhe fazen e hartimit te preventivit te punimeve.

Megjithese e Detyre e Projektimit, nuk eshte kerkuar te behet nje analize hidrologjike qe lidhet me kapacitetin e kanalit ushqyes te ujembledhesit te Llakaj, Oponenca mendon se nje analize e tille do te ishte e nevojshme per te percaktuar prurjet qe vijne ne kete ujembledhes ne periudha te ndryshme te vitit duke bere te mundur edhe nje menaxhim dhe permiresim te skemes se ujitjes e zone

1.2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVI I PROJEKTIT

Objektivi i pergjithshem i projektit eshte ujitja e tokave ne zonen e projektit permes pastrimit dhe rehabilitimit te kanaleve ushqyes dhe rikonstruksionit te vepres se marrjes se ujit ne digen e Llakaj. Gjatesia e kanaleve ushqyes qe duhet te pastrohen dhe rehabilitohen jane afro 3 km .

Qëllimi i punes eshte **hartimi i projektit te zbatimit per rehabilitimin e kanalit ushqyes te ujembledhesit te Llakaj dhe rehabilitimi i skemes se ujitjes ne kete zone me synimin e rritjes se kapacitetit te ujitjes nga kjo skeme**, kryerja e nje analize teknike -ekonomike te

kostos se projektit duke u mbështetur ne situaten ekzistuese, ne zgjidhjet e dhena nga projektuesi, ne standartet e projektimit si dhe ne kerkesat e legjislacionit ne fuqi.

1.3 ZONA E PROJEKTIT

Zona e projektit perfshin zonen e fshatit Llakaj ne bashkine Has ne nje gjatesi prej afro 3 km dhe ne nje zone bujqesore prane ketij fshati. Bashka e Hasit ndodhet ne pjesen verilindore të Shqipërisë, ne qarkun e Kukësit dhe kufizohet në veriperendim me bashkine Tropoje, ne juglindje me bashkine Kukës.

1.4 GJENDJA EKZISTUESE

Sipas grupit te projektit, aktualisht Ujembledhesi i Llakaj eshte ne gjendje te mire pune dhe operimi. Problemi kryesor per kete veper ujtese eshte se mbushja e tij me uje behet vetem me kanalin ushqyes nga perroi i Vlahnes.

Situata ne kanalin ushqyes eshte problematike duke qene se prita e ndertuar vite me pare per te futur uje ne kanalin ushqyes eshte demtuar plotesisht. Kanali ekzistues i cili kalon ne nje zone pyjore me gjatesi prej afro 2 km ka demtime ne veshjet me beton si dhe ka mbushje me material nga skarpata duke e zvogeluar shume kapacitetin percjelles te tij

Sipas grupit te projektimit, kanali eshte pothuajse jasht funksionit dhe mjaft i amortizuar Gjithashtu, ne zone, sipas konsulentit vihet re fenomeni i erozionit te tokes dhe paqendrueshmerise se skarpateve.

Sipas detyres se projektimit dhe Projektuesve, gjendja ne kete zone eshte mjaft problematike sidomos ne lidhje me demtimet dhe amortizimin e kanalit te ushqimit per shkak te aluvioneve, mbushjes me plastika te hedhura si dhe per shkak te mosfunksionimit te te gjithë sistemit duke perfshire edhe mbushjen e kanalit ne fjale me aluvione apo demtimeve te tjera te ketij sistemi qe prej vitesh.

2 DOKUMENTACIONI TEKNIK I PROJEKTIT TE PARAQITUR

Grupi i projektimit ka pregatitur nje dokumentacion teknik per projektin me objekt: “Rehabilitimi i Kanalit Ushqyes te Ujembledhesit te Llakaj dhe rehabilitimi i skemes Ujtese te zones ne **Bashkine Has**”, i cili permban informacionin teknik ne lidhje me gjendjen ekzistuese si dhe konkluzionet e projektuesve per masat qe duhet te merren per tu zbatuar ne kete faze e cila synon pastrimin e kanalit nga mbushjet qe kane ndodhur, veshjen me beton te

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

kanalit, venien ne funksion te veprave te artit dhe venien e tyre ne gadishmeri per rritjen e kapaciteteve te ujitjes se tokave dhe sistemit te ujitjes ne zone

Dokumentacion Teknik perbehet nga:

2.1- Relacioni Teknik ne te cilin jepen:

- Te dhena te detyres se projektimit
- Te dhena te pergjithshme per zonen
- Kushtet Klimatike te zones
- Te dhenat per hartimin e projektit
- Te dhenat e vecanta per realizimin e projektit
- Gjendja ekzistuese
- Zgjidhja teknike e projekt zbatimit
- Metodika e hartimit te projektit
- Relacioni Topografik
- Relacioni i llogaritjeve Hidraulik
- Volumet e punimeve
- Organizimi I punimeve
- Konkluzione

2.2- Vizatimet Teknike te perbera nga:

- Planimetria
- Prekje gjatesore dhe terthore te kanalit
- Detaje te ndryshme

2.3- Specifikimet teknike:

- Te pergjithshme
- Punime Germimi dhe Mbushje
- Punime Betoni dhe hekuri
- Punime per vepra e artit
- Punime shtresash, etj

2.4- Preventivi i Punimeve per:

- Punime ne vepren e marrjes
- Punime per kanalin ushqyes me gjatesi 2859 ml
- Punime per Rehabilitimin e skemes ujtese
 - Kanali ujites KU-1
 - Kanali Ujites KU-11
 - Kanali Ujites KU -12



○ Kanali Ujites KU - 20

2.5- Raportet mbështetese per topografine, Gjeologjine, Llogaritjet hidraulike dhe konstruktive, Relacioni i Vleresimi te ndikimit ne mjedis, etj

2.6-Grafiku i Punimeve i cili parashikon qe punimet mund te zbatohen per 9 muaj

3 RELACIONI TEKNIK

Me poshte jepen ceshtjet kryesore te analizuar nga Grupi i Oponences ne lidhje me Relacionin Teknik te paraqitur si me poshte:

a- Objektivat e Projektit

Konsulenti ka dhene qe ne fillim te Raportit Teknik, Objektivat e Projektit qe ka patur per synim te realizoje ne punimet e propozuara te cilat konsistojne ne riaftesimin dhe mirefunksionimin e infrastruktures se ujitjes se tokave ne kete zone si dhe permiresimin e treguesve kryesore te kanalit te ushqimit dhe te skemes se ujitjes.

Sipas Projektuesit nje prej objektivate te projektit te kerkuar nga Klienti eshte edhe pastrimi i mbetjeve te ngurta ne kanal nga aluvionet qe e kane mbushur kete kanal.

Nga shqyrtimi i masave prioritare te percaktuara nga Konsulenti, **Oponenca veren se prioritet e dhena nga Konsulenti per rehabilitimin e kanalit ushqyes te ujembledhesit Llakaj dhe Rehabilitimi i skemes ujitese e zonen e projektit ne pergjithesi perputhen me kerkesat dhe objektivat e dhena ne detyren e projektimit.**

b- Zona e projektit

Zona e projektit përfshin zonen e njesise administrative te fshatit Llakaj te Bashkise Has te percaktuar ne detyren e projektimit.

c- Pershkrimi i Konceptit te projektit per permiresimin e sistemit te ujitjes

Projekti i paraqitur synon permiresimin dhe mirefunksionimin e Infrastruktures se ujitjes per zonen e fshatit Llakaj permes rehabilitimit te kanalit ushqyes te Ujembledhesit te Llakaj dhe rehabilitimin e skemes se ujitjes duke i dhene prioritet vendosjes ne pune te kanalit ushqyes te ujembledhesit, vepres se marrjes se ujit si dhe rehabilitimit te 4 kanaleve te sistemit te ujitjes. Nga ana tjeter, ne relacionin teknik eshte dhene nje pershkrim i pergjithshem teorik per metoden e llogaritjeve, treguesit teknike te perdorur dhe koeficientet perkates.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

d- Zbatimi i projektit dhe Organizimi i Puneve

Ne Raportin Teknik te paraqitur, Konsulenti ka dhene nje grafik punimesh dhe nje shpjegim te pergjithshem per zbatimin e punimeve. Oponenca mendon se koha e dhene per zbatimin e volumit e punimeve te parashikuara prej 9 muajsh eshte e mjaftueshme.

Ne kapitullin e specifikimeve teknike te pergjithshme jane dhene disa elemente te pergjithshem te planit te organizimit te punimeve te cilat mendojme se jane te mjaftueshme per zhvillimin e aktiviteve te ndertimit nga Kontraktori. Oponenca rekomandon qe Plani i organizimit te punimeve mund te jepet ne detaje dhe te jete i shoqeruar me nje harte te vendodhjes se karriera te parashikuara per marrjen e materialeve inerte, dhe venddepozitimin e mbetjeve.

e- Pershkrimi i Punimeve

Ne Raportin Teknik dhe e Specifikimet teknike te paraqitura jae dhene pershkrimi i disa punimeve kryesore ne lidhje me germimet dhe mbushjen e kanaleve, puimet e betonit, punimet e riparimit e tomio dhe e shkarkues. Ne raport nuk jepet informacion ne lidhje me burimet ku do te merren materialet inerte apo informacioni i duhur per vendndodhjet e karriera te parashikuara per venddepozitimin e materialeve. Gjithashtu, ne kete raport nuk jepen ndonje pershkrim per procesin e zbatimit te punimeve dhe organizimin e tyre.

f- Kushtet e shesheve te ndertimit

Ne specifikimet teknike te pergjithshme, ne nje kapitull me vehte jane dhene pershkrimi i kushteve klimaterike te zones, topografia e zones si dhe te dhena teknike te tjera qe i sherbejne njohjes se zones dhe zbatimit te punimeve ne menyre sa me te pershtatshme dhe te lehte.

Oponenca veren se Konsulenti ka dhene nje informacion te pergjithshem dhe te mjaftueshem ne lidhje me kushtet topografike dhe gjeologjike per zonen ku ndodhet Fshati Llakaj ku do te zbatohet projekti.

4 STUDIMET DHE RAPORTET NDIHMESE MBESHTETESE

4.1 Matjet dhe Raporti Topo – Gjeodezik per zonen e projektit

Per nje pasqyrim real te gjendjes ekzistuese dhe te zones ku do te zhvillohet projekti, Grupi i projektimit ka kryer matjet topografike ne zonen ku ka parashikuar te ndertohen nenobjektet e parashikuara. Ne nje Raport te vecante, grupi i projektit ka dhene bazen dhe metodika e punes se kryer, pikat kyce te sistemit, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

Rilevimi topografik i zones ka patur per qellim te percaktoje situaten aktuale te terrenit, trasene e vendosjes se linjave kryesore, volumet e punes per ndertimin e linjave dhe te objekteve kryesore, etj. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne relacionin teknik dhe ne vizatimet teknike perkatese vihet re se matjet jane kryer duke perdorur pajisje bashkekohore te saktetise se larte.

Gjithashtu, te dhenat e matjeve dhe i gjithe informacioni i duhur eshte perpunuar me ane te programeve software perkatese, duke gjeneruar rezultate te cilesise se larte dhe pregatitur profilet gjatesore te linjave dhe hartat perkatese me saktesi te madhe.

Oponenca veren se matjet topogjeodezike te kryera per te gjitha nenobjektet e sistemit te kanalit ujitjes si dhe rilevimi dhe hartat e pregatitura nga ekipi i gjeodeteve kane qene nje baze e mire per grupin e projektimit ne percaktimin e trasese se linjave te shperndarjes se ujit per ujitje, planimetritre e vendosjes se prizave kryesore dhe nyjeve kyce te sistemit te ujitjes si dhe per percaktimin e volumeve te punes.

4.2 Studimi Gjeologo-inxhinierik

Konsulenti ka paraqitur ne nje kapitull te vecante nje pershkrim te pergjithshem te kushteve Gjeologo – Inxhinierike per zonen. Ne Relacionin teknik te dorezuar prane Oponences eshte dhene nje informacion i pergjithshem per zonen e sherbimit.

Ne raportin Gjeologo – Inxhinierik, Konsulenti ka dhene informacion per kushtet gjeomorfologjike te zones, granulometrine e dherave dhe vetite fiziko mekanike te tyre, kushtet tektonike dhe qendrueshmerine e siperfaqeve si dhe nje informacion te pergjithshem per sizmicitetin e zones dhe bazamentin e veprave qe do te ndertohen duke arritur ne konkluzionin se ne pergjithesi sheshet e ndertimit te ketyre veprave jane me kushte te mira.

4.3 Raporti Hidraulik

Konsulenti ka paraqitur nje raport hidraulik ku jepet edhe skema e ujitjes si dhe disa llogaritje per kapacitetin e kanalit ushqyes e cili ka bere te mundur te jepet nje panorame e mire e lidhje me permasimi e ketyre kanaleve si dhe per te bere llogaritjet perkatese hidraulike per permasimin e kanalit te ushqimit te parashikuar ne projekt.

Gjithashtu, Konsulenti ka bere nje trajtim te pergjithshem teorik per percaktimin e shireses llogaritese te shiut si dhe te prurjeve maksimale me siguri te ndryshme qe mund te vijne ne zone.

Grupi i projektimit ka dhene ne Relacionin Teknik si dhe ne nje raport te vecante se si duhet te behen llogaritje hidraulike per permasimin e kanalit dhe per kapacitetet percjelles te tij si dhe rezultatet e ketyre llogaritjeve.

Gjithashtu, nga verifikimi i ketyre llogaritjeve permes programeve kompjuterike, rezulton se te kanali pas rikonstruksionit dhe pastrimit te tij do te jete ne gjendje te percjelle sasine e ujrave qe duhet per ujitjen e tokave ne zonen e projektit bazuar ne standartet dhe kriteret per projektimin e ketyre kanaleve.

4.4 Projekti dhe Llogaritjet Strukturale

Pjesë e këtij projekti është Rehabilitimi i kanalit ushqyes te Ujëmbledhësit Llakaj dhe rehabilitimi i skemës ujitëse. Grupi i projektimit ka dhene nje Raport te vecante per nderhyrjet konstruktive te kanalit dhe veprave te artit te parashikuara ne projekt. Ne Raportin Teknik jane gjendja ekzistuese dhe zgjidhjet qe do te behen ne projekt

Projekti konstruktiv i rehabilitimit te skemes ujitese konsiston ne rehabilitimin e kanaleve ujitese. Sipas detajeve kanali do te vishet me beton te Klases C16/20, me nje trashesi $t=10\text{cm}$ dhe me fuga $t=2\text{cm}$, cdo 3.0m . Sipas prerjeve terthore ka dhe kanale me veshje me mur guri.

Gjithashtu pjese e ketij projekti eshte dhe rehabilitimi i ures se kembesoreve me $H_d=2.0\text{m}$ dhe $B=2.0\text{m}$.

Lugu eshte projektuar me strukture b/a me mure me trashesi 20cm .

Sipas preventivit te punimeve per punimet ne kanal, lug, tombino, priza, betoni do te jete i klase C16/20.

Projekti i Reabilitimit te kanalit ushqyes te Ujëmbledhësit Llakaj

Nderhyrjet ne kete projekt do te realizohen ne vepren e marrjes dhe kanalit ushqyes.

Vepra e marrjes përfaqëson elementin kryesor të furnizimit të sistemit me ujë dhe ka funksion devijimin e kontrolluar të prurjeve drejt kanalit ushqyes.

Nga inspektimi në terren janë konstatuar dëmtime sipërfaqësore të betonit, konsumim i pjesëve metalike dhe depozitime sedimentesh në afërsi të veprës.

Ndërhyrja parashikon:

- pastrim të plotë;
- riparim të betonit të dëmtuar;
- restaurim të elementeve metalike;
- rehabilitim të nyjeve konstruktive.

Kanali ushqyes është projektuar me seksion të hapur dhe shërben për transportimin e ujit drejt ujëmbledhësit.

Nga pikëpamja konstruktive janë konstatuar:

- dëmtime të shtresës së betonit;
- erozion lokal;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

- humbje të seksioneve anësore;
- degradim të fugave.

Punimet konsistojnë në:

- riprofilimin e seksionit;
- realizimin e veshjeve të reja prej betoni;
- riparimin e elementeve ekzistuese;
- stabilizimin e skarpatave.

Përfundime dhe rekomandime për projektin konstruktiv

- Projekti konstruktiv për strukturat e paraqitura në përgjithësi është i sakte, por ai duhet të plotësohet dhe me shenime teknike në lidhje me materialet që do të përdoren për veprat e këtij projekti.
- Projekti konstruktiv duhet të plotësohet me të gjithë detajet e Veprave të parashikuara në preventiv. Raporti konstruktiv duhet të jetë me i plotë, pasi bëhet vetëm një përshkrim të nderhyrjeve dhe gjendjes ekzistuese, ai duhet të shoqërohet me llogaritje konstruktive.
- Strukturat ujëmbajtëse duhet të projektohen të jenë me material (beton dhe çelik) të markave të larta të cilat përmbushin kërkesat për mospërkueshmërinë ndaj ujit siç jepen në projekt.
- Për strukturat e këtij projekti duhet të respektohen kushtet teknike për armimet e elementeve konstruktive.

5. RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Është dorëzuar për Oponencë objekti: “Skema ujitëse Llakaj, HAS”. Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur nga Ing. Kreshnik AHMETAJ bashkëngjitur Deklarata e Përgjegjësisë Profesionale dhe nënshkruar nga Gramos Skenda. **Mungojnë bashkëngjitur Certifikata e Mjedisit e ekspertit që e ka përgatitur si dhe Licenca nga QKL për veprimtari lidhur me ndikimin në mjedis!**

Raporti i VNM-së është hartuar dhe analizuar sipas kërkesave të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 për VNM-në me VKM nr.686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”.

Në Raport janë përshkruar:

- Përshkrimi dhe qëllimi i projektit, i cili synon rehabilitimin e skemës ujitëse ekzistuese e cila është plotësisht jashtë funksionit për shkak të amortizimit dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

dëmtimit të veprave. Kanali fillon nga ujëlëshuesi, riparim pjesor i kanalit kryesor KU-1 dhe vazhdon me rehabilitim total të gjithë kanaleve të tjerë kryesorë dhe sekondarë. Zona ku shtrihet projekti është zonë rurale që kryesisht meren me bujqësi dhe blektori.

- Gjendja ekzistuese e Skemës ujitëse Llakaj, e cila e merr ujin nga rezervuari Llakaj, burimi kryesor.
- Përshkrimi i proceseve të punës. Parashikohen ndërhyrje në: riseksionimi i të gjithë gjatësisë së kanalit, veshje me beton dhe skarpata, ndërtimi i prizave për marrjen e ujit, ndërmirëmbajtje dhe shkarkuesëve për largimin e ujërave gjatë periudhës së dimrit, riparim dhe ndërtim mure guri mbajtës dhe pritës, ndërtimi i urave këmbësorësh dhe auto për hyrje në parcela pa cënuar kanalin, dhe riparim ujëlëshuesish.
- Janë identifikuar ndikimet e mundshme negative në mjedis si dhe shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve; Faza ndërtimore parashikon punime ndërtimore nga ku gjenerohen mbetje të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e ujërave.

Masat kryesore lehtësuese të dhëna në raport janë kushte për tu zbatuar nga zhvilluesi i projektit. Gjatë fazës së punimeve do të ketë ndikime dhe ndryshime në parametrat mjedisorë si pasojë e rritjes së niveleve të ndotjes për shkak të zhurmës, ndotje të ajrit për shkak të emetimit të pluhurave. Pjesa e prekur nga zhvillimi i projektit, sipërfaqja e tokës duhet të rehabilitohet.

- Programi i monitorimit, si një detyrim ligjor, i cili identifikon palët përgjegjëse për monitorimin, treguesit dhe nevojat për trajnim apo për ngritjen e kapaciteteve dhe raportimin. Subjekti ndërtues duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar, parandaluar e shmangur këto impakte, duke siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.
- Mbetjet inerte që do gjenerohen nga punimet, duhet të depozitohen konform VKM nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" në vendepozitimet e miratuara nga bashkia Has.

Gjatë punimeve për zbatimin e projektit duhen patur parasysh këto rekomandime:

1. Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
2. Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.
3. Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

4. Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
5. Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, duke përfshirë këtu edhe sasinë e dherave që nuk do të përdoren duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Të specifikohet venddepozitimi i miratuar për dherat dhe inertet që do të dalin nga punimet!

Ndikimet që vijnë si rezultat i zhvillimit të projektit do jenë prezente deri në përfundim të punimeve. Të zbatohen plani i masave zbutëse dhe plani i monitorimit për ndikim sa më minimal!

T'i bashkëngjiten Raportit të VNM-së Certifikata e Mjedisit e ekspertit si dhe Licenca nga QKL për veprimtari lidhur me ndikimin në mjedis!

6. SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE PERSHKRIMI I PUNIMEVE

Konsulenti ka dhënë specifikimet teknike për punimet e zbatimit që parashikohen të kryhen në objektet kryesore të kanali ushqyes dhe skeme të ujitjes të parashikuara për tu rehabilituar.

Specifikimet teknike të paraqitura përmbajnë:

- Te përgjithshme
- Punime Germimi dhe Mbushje
- Punime Betoni
- FV Tuba
- Muret me Gabion
- Punime të Ndryshme

Për sa më sipër, Oponenca arrin në përfundimin se specifikimet teknike në përgjithësi japin një pasqyrë të plote për punimet e ndërtimit dhe në mënyrë të vecantë për punimet e germimit, mbushjeve, punimet e betonit, FV tubave si dhe për punimet mbështetëse. Këto specifikime shërbejnë si një bazë e mirë për zbatimin e punimeve të ndërtimit me cilësi dhe për kontrollin e cilësive të hekurit dhe betoneve që janë mjaft të rëndësishme për sistemin në të ardhmen.

Megjithatë Oponenca sugjeron që Projektuesi duhet të përfshijë edhe specifikimet teknike për porten metalike të parashikuara tek vepra e marrjes, urat kembesore, pemet dekorative, etj.

7. PREVENTIVI I PUNIMEVE DHE VLERESIMI I KOSTOVE

Preventivi i punimeve për objektin: “Rehabilitimi i Kanalit Ushqyes të Ujëmbledhësit Llakaj dhe Rehabilitimi i skemes së ujitjes së zonës së Llakaj të **Bashkisë Has**”, është paraqitur në fletë format A4 e hartuar, firmosur dhe vulosur nga Konsulenti. Nga shqyrtimi i këtij preventivi dhe vleresimit të kostove rezulton se **Vlera totale për zbatimin e punimeve për zbatimin e projektit është vlerësuar të jetë në Shumën totale prej 116, 322, 323 leke (me TVSH). Në këtë vlerë përfshihet fondi rezerve prej 5 % por nuk përfshihen kostot për mbikqyrjen e punimeve apo kolaudimin e tyre.**

Në preventivin e paraqitur, Konsulenti ka dhënë të ndarë punimet civile që do të kryhen për objektet kryesore të parashikuara në projekt. Preventivi i paraqitur është i shoqëruar me analizë të çmimeve njësi për zërat e punimeve të parashikuara në të një përputhje me Manualin Teknik të Çmimeve aktualisht në fuqi (VKM Nr. 216, datë 13.04.2023).

Për sa më sipër, Oponenca është e mendimit se Konsulenti në përgjithësi ka dhënë një Preventiv të plotë për zërat e punimeve të parashikuara në projekt.

8. VIZATIMET TEKNIKE TË PROJEKTIT TË ZBATIMIT

Materiali grafik i vënë në dispozicion të oponecës përbehet nga fletë vizatimi në format A3. Gjykuar nga niveli i detajimit dhe informacionit të dhënë në këto vizatime mund të thuhet që ato japin një paraqitje grafike të mjaftueshme për zbatim në të gjitha objektet e projektuara në nivelin e zbatimit të projektit për rehabilitimin e kanalit ushqyes të ujëmbledhësit të Llakaj dhe rehabilitimin e skemes së ujitjes duke e bërë të realizueshëm nga ana teknike zbatimin e tij si dhe kontrollin e vëllimeve të punimeve që do të kryhen në kuadër të zbatimit të tij.

Projekti i paraqitur mbështetet në një material grafik të pranueshëm në shkallën që kërkohej për një projekt zbatimi. Vizatimet teknike japin planimetrinë e përgjithshme të kanalit si dhe disa prerje tërthore të tij.

Në dokumentacionin teknik jepen detaje të të gjithë elementeve të sistemit. Shkalla e përdorur, detajet e dhëna si dhe numri i vizatimeve të projektit lejon një zbatim të mirë të punimeve si dhe një kontroll korrekt.

Pozicioni i objekteve që do të rikonstruohen sipas këtij projekti në kuadër të hartës së Shqipërisë identifikohet lehtë me anë të planimetrisë së nxjerre nga hartat topografike në shkallë 1:10000.

Duke e parë nga pikpamja e zbatimit si dhe përputhjes me kriteret e kërkuara, që janë përdorur për përmatimin e objekteve, **Oponenca arrin në përfundim se:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

- a. Vizatimet teknike per punimet e parashikuara ne projekt kane dhene nje pershkrim te mjaftueshem te elementeve te kanalit duke bere te mundur edhe percaktimin e volumeve te punes per cdo element dhe kontrollin e tyre me lehtesi.
- b. Shkalla e zgjedhur ne Vizatimet teknike eshte e mjaftueshem dhe e pranueshme per nje zbatim te thjeshte te projektit te paraqitur.
- c. Vizatimet Teknike jane shoqeruar me shenime teknike te cilat do te ndihmojne jo vetem ne zbatimin me cilesi te tyre por edhe ne kontrollin e sasise e cilesise se punimeve.

9. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nga studimi dhe analiza e dokumentacionit teknik te vene ne dispozicion Oponenca ka arritur ne perfundimet dhe rekomandimet si me poshte:

- **Zgjidhja teknike** e dhene nga Konsulenti per skemen hidraulike te kanalit ushqyes te ujembledhesit te Llakaj, skemes hidraulike te sistemit te ujitjes si dhe prioritetet e percaktuara ne pergjithesi jane te pranueshme dhe te pershtatshme per zgjidhjen e problemeve qe kane dale ne zone sipas standarteve teknike te kerkuara dhe kerkesave te Detyres se Projektimit.
- Konsulenti ka dhene metodiken e llogaritjeve hidraulike per permasimin e kanalit ushqyes dhe te 4 kanaleve te sistemit te ujitjes te shoqeruar me llogaritje konkrete hidraulike dhe analizen teknike per permasimin e tyre. Permasimi i kanalit ushqyes eshte bazuar ne projektin orgjinal.
- **Raportet mbeshtetese** qe jane paraqitur nga Konsuleti sic jane raportet topografike, hidraulike, Konstruktive, gjeologjike dhe te Vleresimit te ndikimit ne mjedis jane nje mbeshtetje teknike per analizen e kryer dhe zgjidhjet teknike te dhena nga Konsulenti
- **Vizatimet teknike** japin nje pamje grafike relativisht te detajuar ne lidhje me punimet qe do te kryhen si dhe nenobjektet kryesore te sistemit ku do te punohet. Ato jane pregatitur ne perputhje dhe te lidhura ngushte me kushtet teknike te zbatimit dhe standartet teknike te dhena ne projekt.
- **Preventivi dhe Vleresimi i Kostos se punimeve** te ndertimit ne pergjithesi jane bazuar ne manualet zyrtare si dhe ne cmimet e tregut aktual ne zonen e ndertimit.
- **Periudha e ndertimit** e dhene ne grafikun e punimeve prej 9 muajsh eshte e pranueshme dhe e realizueshme permes nje programi te detajuar masah qe duhet te merren paraysh nga zbatuesi i punimeve. Oponenca sugjeron qe ne grafiku e punimeve duhet te shtohet edhe periudha e garancise se puimeve prej 12 muajsh

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

- **Specifikimet teknike** japin një pasqyrë të plotë për kërkesat teknike të zbatimit të punimeve dhe materialeve që do të përdoren gjatë zbatimit të projektit duke dhënë mundësinë e zbatimit të punimeve në sasinë dhe cilësinë e duhur në përputhje me kërkesat e standarteve teknike. Këto specifikime duhet të plotësohen edhe me kërkesat teknike për portën metalike, urat e kembësoreve, etj
- Zbatuesi i Punimeve duhet të japë përpara fillimit të punimeve vendndodhjen e karrierve të marrjes së materialeve të ndërtimit të shoqëruar edhe me lejet përkatëse për shfrytëzimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

PËRFUNDIM

Për sa më sipër, Oponenca ka arritur në konkluzionin se Zgjidhja Teknike e dhënë nga Konsulenti për Rehabilitimin e Kanalit Ushqyes të Ujëmbledhës të Llakaj dhe rehabilitimi i skemës së ujitjes në zonën e projektit nga ky ujëmbledhës **ne përgjithësi është zgjidhje e pranueshme dhe e zbatueshme në përputhje me kërkesat teknike dhe standartet përkatëse si dhe me kërkesat e detyrës së projektimit.** Projekti duhet të plotësohet me mungesat e mësipërme si dhe me disa specifikime teknike dhe llogaritjet përkatëse për portën metalike dhe për urat kembësore të parashikuara nga Konsulenti.

GRUPI I OPONENCËS

Ing. Hidroteknik. Arjan JOVANI

Nr.Lic.H/T.0003/3

Ing.Konstruktor. Valbona PONDE

Nr.Lic.K.1562/3

Ing.Mjedisi.Eglantina CEKICI

Nr.Lic.M.1663

PËRGJEGJËSE E SEKTORIT TË OPONENCAVE

Ing. Mamica SHEHI

DREJTOR DREJTORIE

Ing. Valbona PONDE

